



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 17 Prill 2021

Nr: 250

VENDIM

Objekt: Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ndaj deputetit z. Erion Braçe.

Kërkues: Anonim

Ndaj: Z. Erion Braçe, Deputet i Kuvendit të Shqipërisë

Baza ligjore: Nenet 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f” dhe ‘n’, paragrafi 2, dhe 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 44, 77 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, vendimi nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga administrata gjatë procesit të hetimit administrativ,

VËREN:

I



Vlerësimi paraprak

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, është raportuar një kallëzim në email denoncime.kqz@gmail.com, për veprimtarinë deputetit z. Erion Braçe, i cili në faqen e tij të facebook ka shpërndarë materiale, që bien në kundërshtim me vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve” të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në kallëzimin e raportuar më datë 24.03.2021, ora 20:55, protokolluar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me nr. 3180 prot., datë 03.04.2021, pretendohet se: *“Në këtë fushatë elektorale po shfrytëzohen fëmijët në mënyrë të padrejtë. Ju lutem merrni masa se po bëhet fenomen i vazhdueshëm”*. Bashkangjitur denoncimit, si provë për është dërguar fotografia e z. Erion Braçe shoqëruar me një grup fëmijësh .

Sipas përcaktimeve të nenit 23, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shqyrtoi paraprakisht kërkesat lidhur me kompetencën e

organit publik për shqyrtimin e tij.

Sipas përcaktimeve të neneve 19, paragrafi 1, shkronja “dh” , “f” dhe “n”, paragrafi 2, dhe 91, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kompetencat si më poshtë:

dh) kujdeset për zbatimin e këtij ligji në mënyrë të drejtë, të përpiktë, të saktë dhe uniforme nga të gjitha institucionet, subjektet apo personat e ngarkuar me detyra dhe detyrime, sipas ligjit;

f) monitoron nëpërmjet administratës së KQZ-së apo subjekteve të kontraktuara sjelljen e institucioneve publike gjatë fushatës dhe përdorimin e burimeve publike;

n) ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Bazuar në nenin nenit 6, pika 4, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021 “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht kallëzimin nga denoncuesi i cili ka kërkuar të mbetet anonim pa treguar qartësisht shkaqet e anonimatit, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e

mundëshme mbi të kallëzuarin. Gjithashtu, referuar nenit 3, paragrafi 2 të vendimit nr. 9/2020, deputeti dhe kandidati për deputet nuk përfshihet në rrethin e subjekteve, që e kanë të ndaluar të drejtojnë, të marrin pjesë apo të kontribuojnë në çfarëdolloj forme, në veprimtari publike të ndaluara sipas këtij vendim.

Në këto kushte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të fillojë një procedurë administrative të kërkuar nga denoncuesi për shkak se **informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet si dhe për shkak të mungesës së kompetencës ndaj subjektit.**

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, paragrafi 1, shkronja “dh”, “f”, “n”, paragrafi 2, 91 dhe 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimi nr. 9/2020 dhe vendimit nr.9/2021, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative për z. Erion Braçe.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen me postë elektronike denoncuesit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

